



EDUKIMI MJEDISOR



Nëntor 2025

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga **12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **nëntor 2025**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

**“Mjedisi dhe ekonomia janë dy anë të së njëjtës medalje.
Nëse nuk mbrojmë mjedisin, nuk mund të mbijetojmë as vetë.”**
Wangari Maathai

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe **ndërgjegjësim** për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe **analizojnë** probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe **përfshihen** për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe **veprimtari** që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Nxënës të përfshirë **682**

Specialistë të angazhuar **24**

Orë mjedisore të realizuara **37**

37 Shkolla të përfshira

37 Mësues të përfshirë

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



11 nëntor 2025, orë e hapur mjedisore

Specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orë të hapur mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Rifat Nuzi” pranë Monumentit të Natyrës “Gështenjat e Reçit”. Aktiviteti u konceptua si një udhëtim njohës në pyllin e gështenjave, ku nxënësit mblodhën frytet e stinës dhe u njohën me vlerat ekologjike, kulturore dhe edukuese të këtij monumenti natyror. Përmes këtij aktiviteti, nxënësit mësuuan rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe lidhjen e njeriut me mjedisin, duke përfshirë edhe elemente të biodiversitetit ujor të zonave përreth.

19 nëntor 2025, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Rifat Ziberi”, morën pjesë në një orë mjedisore të organizuar nga specialistët e AdZM Shkodër. Ata u njohën me kamerat kurth dhe rolin e tyre në monitorimin e faunës së egër në zonat e mbrojtura. Përmes fotove dhe videove të kapura nga kamerat kurth, nxënësit panë pamje të rralla të kafshëve të egra dhe mësuuan më shumë për mënyrën e jetesës së tyre. Gjithashtu, përmes pikturave dhe materialeve edukative, u njohën me lloje të ndryshme të faunës dhe ekosistemet ujore, duke kuptuar rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit në habitatet e mbrojtura.

monument natyre

edukim mjedisor

“Gështenjat e Reçit”

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



7 nëntor 2025, kafshë të egra

Në kopshtin “Dervician” specialistët e AdZM Gjirokastër zhvillua një orë mjedisore me fëmijët mbi temën “Kafshët e egra”.

Fëmijët u njohën me botën magjike të kafshëve të egra, ngjyrosën me dashuri kafshët e tyre të preferuara dhe mësuara për mënyrën e jetesës, rolin ekologjik dhe rëndësinë e tyre në natyrë. Aktiviteti u shndërrua në një ditë të mbushur me krijimtari, argëtim dhe mësim për mjedisin, duke ndihmuar fëmijët të ndërtojnë lidhje të hershme me natyrën dhe biodiversitetin.

8 nëntor 2025, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Specialistët e AdZM Gjirokastër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Nonda Bulka”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Zonave Urbane. Qëllimi i aktivitetit ishte të rritej ndërgjegjësimi tek nxënësit për rëndësinë e ruajtjes së hapësirave të përbashkëta urbane të gjelbëruara, si parakusht për një mjedis të shëndetshëm dhe komunitete të qëndrueshme. Nxënësit morën pjesë në diskutime dhe aktivitete edukuese për të kuptuar rolin e hapësirave urbane në jetën e përditshme dhe ndikimin e tyre në biodiversitetin lokal.

qyteti i gjelbër
kafshë të egra

reduktimi i mbetjeve

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



14 nëntor 2025, orë mjedisore

AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Papa Gjon Pali II” në Ulëz, me temë “Qyteti i Gjelbër”. Gjatë aktivitetit, nxënësit morën pjesë në punë krijuese për Ditën e Zonave Urbane, ku mësuan mbi rëndësinë e hapësirave urbane të gjelbëruara dhe mënyrat se si të mbajnë qytetin pastër dhe të gjelbër. Nxënësit krijuan një model miniaturë të qytetit të gjelbër, duke zhvilluar kreativitetin dhe ndërgjegjësimin për mjedisin.

20 nëntor 2025, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kurt Cakoni” u angazhuan në një aktivitet krijues për krijimin e një akvariumi. Ata ngjyrosën peshqit dhe algat, disa prej të cilëve i prenë dhe i ngjitën në akvarium, duke ndërtuar një ambient të gjallë dhe edukativ. Aktiviteti ofroi një mënyrë të këndshme për të njohur jetën ujore dhe rëndësinë e ruajtjes së saj në natyrë, duke kombinuar kreativitetin me edukimin mjedisor.

27 nëntor 2025, orë mjedisore

Në kuadër të Javës Evropiane për Zvogëlimin e Mbetjeve, specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Irfan Hajrullai”. Me pankarta motivuese dhe modele të planetit të gjelbër dhe planetit me plastikë, ata kuptuan pasojat e ndotjes dhe rëndësinë e riciklimit. Përmes aktiviteteve praktike dhe krijuese, nxënësit zhvilluan ndërgjegjësim për reduktimin e mbetjeve, riciklimin dhe ndikimin e veprimeve të vogla në ruajtjen e planetit.



qytet i gjelbër

ekosistem

kafshë të egra

“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



7 nëntor 2025, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Specialistët e AdZM Berat zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Zihni Toska”, me fokus riciklimin dhe rëndësinë e tij për mjedisin urban. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me konceptin e riciklimit, përfitimet që sjell ai për mjedisin dhe rolin që secili individ ka në reduktimin e ndotjes. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit dhe nxitjen e sjelljeve miqësore ndaj mjedisit në zonat urbane.

18 nëntor 2025, Java Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Javës Botërore të Edukimit Mjedisor (18–24 nëntor), u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Uznovë, me temë “Mbrojtja mjedisore – Edukimi dhe ndryshimi i sjelljes ndaj mjedisit”. Gjatë aktivitetit u diskutua rëndësia e edukimit mjedisor në formimin e qëndrimeve të përgjegjshme dhe ndikimi që sjell ndryshimi i sjelljes individuale në mbrojtjen e natyrës. Nxënësit u inkurajuan të reflektojnë mbi veprimet e përditshme dhe rolin e tyre në ruajtjen e mjedisit.

ditë botërore
biodiversitet

zona të mbrojtura
ekosistem



“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



2 nëntor 2025, orë mjedisore

Në kuadër të Javës Kombëtare të Ujit, nxënësit e klasës IV të Shkollës 9-vjeçare “Beselidhja” morën pjesë në një orë mjedisore së bashku me stafin e AdZM Lezhë. Fëmijët krijuan një akvarium 3D, duke mësuar rëndësinë e të gjitha qenieve, të mëdha dhe të vogla, dhe rolin e tyre kritik në ekosistemet ujore, si dhe ndërlidhjen e tyre me të gjithë gjallesat.

8 nëntor 2025, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Zonave Urbane, specialistët e AdZM Lezhë angazhuan nxënësit në aktivitete edukuese mbi mbrojtjen e mjedisit në zonat urbane. Pas një prezantimi informues, fëmijët morën pjesë në punë krijuese dhe aktivitete të pavarura, duke shprehur idetë e tyre mbi mënyrat për ta bërë qytetin më të gjelbër dhe më të pastër.

21 nëntor 2025, Dita e Peshkimit

Në kuadër të Ditës së Peshkimit, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Karl Gega”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve ujore dhe peshkimit të qëndrueshëm, përmes një prezantimi informues mbi metodat tradicionale të peshkimit në lagunën e Kune–Vainit, mbrojtjen e faunës ujore dhe ndikimin e njeriut në mjedis. Aktiviteti u pasua me punë të pavarura dhe krijuese, ku nxënësit reflektuan dhe përgatitën materiale edukative mbi njohuritë e fituara.

fauna

zona të mbrojtura


orë mjedisore



27 nëntor 2025, Java për Reduktimin e Mbetjeve

Specialistët e AdZM Lezhë, në kuadër të Javës për Reduktimin e Mbetjeve zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Ndoc Gjetja". Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me konceptin e tre "R"-ve: Reduktim, Ripërdorim dhe Riciklim, përmes një prezantimi në PowerPoint. Më pas, ata morën pjesë në një pyetësor ndërgjegjësues, duke reflektuar mbi mënyrat praktike se si secili mund të kontribuojë për një mjedis më të pastër dhe të shëndetshëm.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



6 nëntor 2025, Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Zonave Urbane, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VII të Shkollës 9-vjeçare “Selman Ali Xaka”, Nuaj. Aktiviteti u organizua në disa faza, ku fillimisht u diskutuan dallimet dhe lidhjet mes zonave urbane dhe rurale, duke theksuar rëndësinë e tyre në jetën e përditshme. Më pas, nxënësit prezantuan punime krijuese përmes vizatimeve dhe përshkrimeve, duke shprehur mënyrën se si i perceptojnë këto zona. Aktiviteti u përmbyll me një aksion konkret mjedisor, mbjelljen e 30 fidaneve pyjorë në mjediset përreth shkollës, duke nxitur përgjegjësinë dhe angazhimin e nxënësve për një mjedis më të gjelbër.

7 nëntor 2025, mjedisi dhe rëndësia e tij

Në kuadër të edukimit mjedisor, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës të shkollës 9-vjeçare “Çudhi”, në mjediset natyrore të Parkut Kombëtar “Qafë-Shtamë”. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe veprimet konkrete që secili mund të ndërmarrë në përditshmëri për ruajtjen e natyrës. Nxënësit patën mundësi të vëzhgojnë nga afër bimësinë dhe faunën e zonës, duke kuptuar rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve natyrore. Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë edukative dhe ndërgjegjësuese, duke inkurajuar fëmijët të krijojnë një lidhje më të fortë me natyrën.

edukim mjedisor

zonat të mbrojtura

biodiversiteti

ndërgjegjësim



12 nëntor 2025, Edhe mjedisi edukon

Me temën “Edhe mjedisi edukon”, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës të shkollës 9-vjeçare “Perlat”, Durrës. Nxënësit u angazhuan në punë krijuese përmes posterave dhe mesazheve sensibilizuese, duke shprehur idetë e tyre mbi ruajtjen e natyrës, ndarjen e mbetjeve dhe kujdesin ndaj gjallesave ujore dhe tokësore. Përmes diskutimeve, nxënësit ndanë shembuj nga përditshmëria e tyre, duke theksuar se ndërgjegjësimi mjedisor fillon nga veprimet e vogla të përditshme.


18 nëntor 2025, gjallesat ujore dhe rëndësia e tyre

Gjatë orës mjedisore me temën “Gjallesat ujore dhe rëndësia e tyre”, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Zenel Qazim Tepshi”, Krujë. Nxënësit u njohën me llojet kryesore të gjallesave ujore, rëndësinë e tyre për ekosistemet dhe ndikimin negativ të ndotjes, veçanërisht të plastikës. Përmes punës në grupe dhe prezantimeve, nxënësit analizuan mënyrat se si ndotja dëmton jetën ujore dhe propozuan zgjidhje konkrete për mbrojtjen e mjedisit ujor. Aktiviteti nxiti mendimin kritik dhe përgjegjësinë mjedisore te nxënësit.

27 nëntor 2025, mbetjet dhe riciklimi

Në kuadër të edukimit mjedisor, specialistët zhvilluan një orë mësimore me fëmijët e Kopshtit “Varosh”, Krujë, me fokus ndarjen e mbetjeve dhe rëndësinë e riciklimit. Përmes aktiviteteve praktike dhe lojës edukative, fëmijët mësuuan të dallojnë llojet e mbetjeve dhe t'i ndajnë ato në mënyrë të saktë. Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë pozitive dhe argëtuese, duke i ndihmuar fëmijët të kuptojnë që në moshë të vogël rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe përgjegjësisë ndaj natyrës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



5 nëntor 2025, Java Kombëtare e Ujit

Në kuadër të Javës Kombëtare e Ujit, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Tufinë”. Nxënësit u njohën me rëndësinë jetike të ujit për tokën, bimët, kafshët dhe njeriun. Përmes lojërave edukative, ushtrimeve, vizatimeve dhe mesazheve ndërgjegjësuese, ata reflektuan mbi nevojën për ruajtjen e pastërtisë dhe kursimin e këtij burimi të çmuar natyror. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit për përdorimin e përgjegjshëm të ujit në jetën e përditshme.

11 nëntor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Tiranë, zhvilluanb një aktivitet krijues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Tufinë”, me fokus përdorimin e materialeve natyrore. Gjatë aktivitetit, fëmijët u njohën me disa kafshë të egra që jetojnë në zonat e mbrojtura, si dhe me veçoritë e tyre dalluese, habitatin dhe ushqimin. Përmes punës praktike dhe krijuese, nxënësit realizuan punime artistike duke përdorur materiale ekologjike, duke nxitur imagjinatën dhe respektin për natyrën.

14 nëntor 2025, një letër pyllit

Në ambientet natyrore të Parkut Kombëtar të Malit me Gropa-Bizë-Martanesh, u zhvillua aktiviteti “Shkruaj një letër pyllit” me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”, Zall Bastar. Nxënësit, të frymëzuar nga bukuria dhe qetësia e natyrës, realizuan kartolina dhe mesazhe sensibilizuese kushtuar pyllit. Aktiviteti shërbeu për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e pyjeve, përfitimet që ato ofrojnë dhe nevojën për mbrojtjen e tyre.

natyrë

kafshët e egra

orë mjedisore

rëndësia e burimeve ujore



21 nëntor 2025, pastrime ekologjike me sfidë kreative

Në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Ymer Lala”, Surrrel, u zhvillua nga specialistët e AdZM Tiranë, një aktivitet mjedisor me nxënësit, i fokusuar në pastrimin e mjedisit dhe ripërdorimin kreativ të mbetjeve. Nxënësit u angazhuan në aktivitete praktike dhe krijuese, duke ndërtuar forma artistike nga materiale të riciklueshme. Përmes këtij aktiviteti, ata u ndërgjegjësuan mbi rëndësinë e zvogëlimit të mbetjeve dhe përdorimit të tyre si burime me vlerë edukative dhe mjedisore.

27 nëntor 2025, Java Evropiane për Zvogëlimin e Mbetjeve

Në kuadër të Javës Evropiane për Zvogëlimin e Mbetjeve, u zhvillua një aktivitet pastrimi me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”, Zall Bastar. Nxënësit u angazhuan në pastrimin e mjedisit përgjatë shtratit të një lumi, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e zonës. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi përgjegjësinë individuale dhe kolektive për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e natyrës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



5 nëntor 2025, orë mjedisore

U zhvillua një orë mjedisore informuese dhe argëtuese nga specialistët e AdZM Elbasan me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Sali Halili”, Rrajcë. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me vlerat natyrore të parkut dhe me rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua krijimit të herbariumit, si një mënyrë edukative për të njohur dhe ruajtur llojet e ndryshme të bimëve që pasurojnë zonën. Aktiviteti nxiti interesin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për florën vendase.

11 nëntor 2025, orë mjedisore

Në Shkollës 9-vjeçare “Daut Gurra”, Dragostunjë, specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me temë “Flora dhe fauna në Parkun Kombëtar Shebenik”. Nxënësit u njohën me vlerat natyrore të parkut, florën dhe faunën karakteristike të zonës, si dhe me bimët e rrezikuara dhe ato mjekësore. Për të krijuar një kuptim më të qartë mbi habitatet natyrore, nxënësve iu prezantuan modele dhe shembuj ilustrues, duke e bërë aktivitetin më konkret dhe edukativ.

19 nëntor 2025, Java Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Javës Botërore të Edukimit Mjedisor, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Isak Alla", Zgosht. Gjatë aktivitetit u prezantua një material informues mbi vlerat natyrore të parkut, florën dhe faunën. Nxënësit u informuan për bimët e rrezikuara, bimët aromatike dhe mjekësore, si dhe morën këshilla praktike për kujdesin dhe ruajtjen e tyre. Aktiviteti synoi rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimit për mbrojtjen e natyrës.

27 nëntor 2025, Java Evropiane për Uljen e Mbetjeve

Në kuadër të Javës Evropiane për Uljen e Mbetjeve, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Dilaver Nezha", Qukës. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi reduktimin e mbetjeve dhe rëndësinë e riciklimit për mbrojtjen e mjedisit. Nxënësve iu demonstrua procesi i ndarjes së mbetjeve sipas përbërjes së tyre, duke theksuar rolin e secilit individ në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Aktiviteti forcoi kuptimin praktik të riciklimit dhe ndikimit pozitiv që ai ka në mjedis.



6 nëntor 2025, vizitë në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta

Specialistët e AdZM Fier mirëpritën fëmijët e kopshtit “Yjet e Jetës”, gjatë një vizite edukuese në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta. Përmes tregimeve të shkurtra dhe komunikimit të drejtpërdrejtë, fëmijët u njohën me disa nga shpendët që jetojnë në park dhe me rëndësinë e mbrojtjes së tyre. Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe edukative, duke nxitur tek fëmijët dashurinë për natyrën që në moshë të vogël.

12 nëntor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Fier, në bashkëpunim me Shoqatën “Horizont EU”, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Hysen Malko”, Kryekuq, Divjakë. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me vlerat natyrore të Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta dhe me rëndësinë e edukimit mjedisor në rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e natyrës. Aktiviteti synoi forcimin e njohurive dhe nxitjen e përgjegjësisë mjedisore te nxënësit.

25 nëntor 2025, Java Evropiane për Reduktimin e Mbetjeve

Në kuadër të Javës Evropiane për Reduktimin e Mbetjeve, stafi i AdZM Fier zhvilloi një aktivitet pastrimi në shtigjet pranë Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta. Gjatë aktivitetit u larguan mbetje të ndryshme dhe u pastruan hapësirat përgjatë shtigjeve, me qëllim përmirësimin e mjedisit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen e natyrës. Ky aktivitet shërbeu si një shembull konkret i përkushtimit ndaj mbrojtjes së zonave të mbrojtura.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



6 nëntor 2025, orë mjedisore

U zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Konferenca e Bujanit”, Bajram Curri, nga specialistët e AdZM Kukës. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rolin e natyrës dhe ndikimin që veprimtaria njerëzore ka mbi të, duke reflektuar mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Ora mjedisore synoi forcimin e ndërgjegjësimit ekologjik, nxitjen e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj natyrës dhe zhvillimin e veprimeve konkrete që kontribuojnë në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm. Aktiviteti shërbeu gjithashtu për të nxitur dashurinë dhe lidhjen e nxënësve me natyrën, duke edukuar brezat e rinj për ta mbrojtur atë.



edukim mjedisor

habitate

zona të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



6 nëntor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Korçë iu bashkuan aktivitetit të organizuar nga Bashkia Kolonjë, në bashkëpunim me shkollën “Piktorët e vegjël”, pjesë e Qytezës së Fëmijëve. Aktiviteti u zhvillua në Parkun Natyror të Gërmenjit, i cili shërbeu si pikë frymëzimi për nxënësit e qarkut Korçë.

Gjatë vizitës, fëmijët u njohën me vlerat natyrore dhe bukuritë e zonave të mbrojtura, duke i pasqyruar ato përmes pikturave të realizuara në telajo. Aktiviteti synoi të nxisë kreativitetin dhe ndërgjegjësimin mjedisor tek nxënësit, duke forcuar lidhjen e tyre me natyrën.

10 nëntor 2025 Java Kombëtare e Ujit

Në kuadër të Javës Kombëtare të Ujit, stafi i AdZM Korçë zhvilloi një aksion pastrimi në Parkun Kombëtar të Prespës, në bashkëpunim me nxënësit e klasave të 8-ta dhe 9-ta të shkollës “Raif Kolami” të fshatit Tren, Bashkia Devoll.

Me entuziazëm dhe frymë bashkëpunimi, nxënësit u angazhuan në pastrimin e një territori të gjerë të parkut, duke mbledhur mbetje dhe duke dhënë një shembull konkret të kujdesit për mjedisin. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e ruajtjes së burimeve ujore dhe ndalimin e hedhjes së mbeturinave në natyrë.

edukim mjedisor

fauna

burime ujore

zona të mbrojtura

13 nëntor 2025, gështenjat

Në kuadër të aktiviteteve edukative për ndërgjegjësimin mjedisor, stafi i AdZM Korçë mirëpriti nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Kozma Basho" të Pogradecit në Pyllin e Gështenjave.

Gjatë ecjes në shtigjet e pyllit, nxënësit u njohën me rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe ekosistemeve pyjore. Të frymëzuar nga bukuria e peizazhit vjeshtor, ata realizuan krijime artistike me gështenja të mbledhura gjatë eksplorimit. Aktiviteti synoi njohjen dhe vlerësimin e gështenjave si pasuri natyrore dhe kulturore.

18 nëntor 2025, Dita Botërore e GIS

Me rastin e Ditës Botërore të Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS), stafi i AdZM Korçë zhvilloi një bashkëbisedim edukues me nxënësit e klasave të 8-ta dhe 9-ta të shkollës së bashkuar "Jani Vreto" në Leskovik. Nxënësit u njohën me rolin dhe rëndësinë e sistemit GIS në mbledhjen, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave mjedisore, si dhe në planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, burimeve ujore dhe biodiversitetit. Aktiviteti synoi afrimin e të rinjve me teknologjitë bashkëkohore në shërbim të mjedisit.

21 nëntor 2025, Dita Botërore e Peshkimit

Në kuadër të Ditës Botërore të Peshkimit, stafi i AdZM Korçë zhvilloi një orë të edukimit mjedisor me nxënës të shkollës "Muharrem Çollaku" në Pogradec, si dhe me peshkatarë të zonës.

Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e ekosistemeve ujore të shëndetshme dhe sfidat që lidhen me ruajtjen e burimeve ujore për brezat e ardhshëm. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimin dhe nxitjen e përgjegjësisë kolektive për mbrojtjen e mjedisit ujor.

27 nëntor – Lini, destinacion kulturor dhe natyror

NStafi i AdZM Korçë zhvilloi një orë të hapur mësimore me nxënësit e shkollës "Myredin Bashllari" në Lin, me temë "Lini si një destinacion turistik kulturor dhe natyror – potencialet dhe sfidat". Nxënësit u njohën me vlerat kulturore dhe natyrore të Lin-it, si dhe me rëndësinë e ruajtjes së tyre për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Aktiviteti synoi forcimin e ndjenjës së përkatësisë dhe përgjegjësisë ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

27 nëntor 2025, Java Evropiane për Zvogëlimin e Mbetjeve

Në kuadër të Javës Evropiane për Zvogëlimin e Mbetjeve, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë të edukimit mjedisor me nxënësit e shkollës "Mustafa Jashari" në Mollas. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi rëndësinë e reduktimit të mbetjeve, riciklimit dhe kujdesit për planetin, duke u ndarë shembuj praktikë dhe ide konkrete për mbrojtjen e natyrës. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimin dhe nxitjen e sjelljeve miqësore me mjedisin.

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



5 nëntor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore me studentët e degës së Biologjisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, me fokus ndotjen nga plastika në mjediset detare, duke nxitur diskutim, reflektim dhe ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit.



Biodiversitet
fauna e egër

ndërgjegjësimit